



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 23, Datë 18.02.2019

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN JANAR 2019**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017 i ndryshuar, me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.06.2018 “Mbi rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”; nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 03.09.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 18.02.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin Janar 2019,

**Konstatoi se:**

- “OSHEE” sha, me anë të shkresës nr.2224 Prot, datë 29.01.2019, paraqiti aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin Janar 2019.
- Informacioni i dërguar në këtë shkresë është përgatitur në mbështetje të Vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 201, datë 04.12.2017. “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, i ndryshuar.
- OSHEE sha, ka llogaritur çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Janar 2019, si vijon:

**Raporti I OSHEE sh.a. ne lidhje me cmimin e llogaritur per FMF per muajin Janar 2019**

Janar 2019		Njesia
a	Cmimi maksimal I blerjes ne treg te parregulluar ose blerja nga prodhuesit me perparesi	14.33 Leke/kWh
b	Kthimi per riskun I percaktuar ne perqindje per vitin (3%)	0.43 Leke/kWh
c	Cmimi maksimal I blerjes ne periudhen relevante	<b>14.76</b> Lek/kWh
d	Kosto administrative te Furnizuesit te Mundesise se Fundit	1.80 Lek/kWh
e	Tarifa e perdorimit te rrjetit te transmetimit	0.75 Lek/kWh
f	Tarifa e perdorimit te rrjetit te shperndarjes	1.5 Lek/kWh
<b>Cmimi I energjise (c+d+e+f)</b>		<b>18.81</b> Lek/kWh
*Cmimi I energjise reaktive (cmimi I energjise aktive *15%)		
*Cmimi I energjise ne pik (cmimi I energjise aktive+cmimi I energjise reaktive)		

- Shoqëria “OSHEE” sha, bashkëlidhur këtij aplikimi, në mënyrë të përmbledhur ka paraqitur informacion mbi realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike, nga tregu i parregulluar.
- Çmimi më i lartë i realizuar për muajin Janar 2019 është çmimi prej 114.77 Euro/MWh për blerjen e sasisë prej 9,968 MWh nga shoqëria “GEN-I TIRANA” për fashën orare 7:00-23:00 në periudhën 18.01.2019-24.01.2019 (Lot 2). Për rrjedhojë, çmimi 114.77 Euro/MWh do të merret në konsideratë për përcaktimin e çmimit për klientët FMF për muajin Janar.
- Sipas informacionit të shoqërisë “OSHEE” sha, për realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar, data 16.01.2019 është data kur kompania ofertuese GEN-I TIRANA (çmimi më i lartë) ka dalë fituese në fazën përfundimtare të negociimit. Data 16.01.2019, duhet të merret në konsideratë për përcaktimin e kursit të këmbimit EUR/Lekë. Sipas publikimeve në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë rezulton se, kursi i këmbimit i përdorur në llogaritjen e çmimit të FMF-së, për datën 16.01.2019 është 1 EUR=124.27 LEK.
- Vërehet se, në këtë aplikim për çmimin FMF për muajin Janar 2019, OSHEE sh.a. ka zbatuar me korrektësi përcaktimet e nenit 8 të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për sa i përket çmimit maksimal të blerjes.

- OSHEE sh.a. ka rillogaritur kostot administrative (CA) bazuar në buxhetin e shoqërisë për vitin 2019, por nsiur nga fakti që ERE me Vendimin nr.268, datë 21.12.2018, la në fuqi pikën 1 dhe pikën 3 të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 190, datë 30.08.2018, “*Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OSHEE” sh.a. për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018*”, OSHEE sh.a. me e-mailin e datës 07.02.2019 protokolluar në ERE me nr. 132, informon se, do të vazhdojë të aplikojë koston administrative si në vitin 2018 (**1.79 lekë/kWh**), për llogaritjen e çmimit FMF-35 kV.
- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratur me Vendimin e Bordit të ERE nr.266, datë 21.12.2018 “*Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria “OST” sh.a. për vitin 2019*”, është 0.75 lekë/kWh.
- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratur me Vendimin e bordit të ERE Nr. 268, Datë 21.12.2018 “*Mbi lënien në fuqi të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 190 datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019*” është 1.5 lekë/kWh.
- Nga verifikimi i informacionit dhe përlllogaritjeve të paraqitura nga “OSHEE” sha, rezulton se, çmimi për shitjen e energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, (FMF), për muajin Janar 2019 është 18.73 Lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Janar 2019 në vlerën 18.73 Lekë/kWh.
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

### **KRYETARI NË DETYRË**

**Adriatik BEGO**